


Alkooli dhe droga

Të rinjtë janë kureshtarë dhe dëshirojnë të provojnë gjëra të reja. Për shëndetin e fëmijës Suaj është me rëndësi të dinë si të shkojnë me mjetet ekscituese dhe ato të varshmërisë (narkotikët). Meqenëse konsumimi i narkotikëve e rrezikon shëndetin e fëmijës Suaj, Ju si prindër jeni të thirrur të ushtroni ndikim në konsumin e fëmijës Suaj.

- Informojuni Ju dhe informojeni fëmijën e Juaj mbi ndikimet dhe rreziqet e mjeteve ekscituese dhe të varshmërisë.
- Merrni parasysh obligimet ligjore.
- Merruni vesh me fëmijën e Juaj mbi konsumin e alkoolit dhe të mjeteve të tjera të varshmërisë.
- Ndalojani fëmijës Suaj të ngasë i dehur automjetin.

Një vështrim i shkurtë ligjit	16 vjeq	18 vjeq
Ruajtja, konsumi dhe shpërndarja e drogave ilegale si kanabisi, kokaina etj. Janë parimisht të ndaluara.		
Shitja e cigareve është e lejuar nga		
Shitja, dhënia dhe konsumi i birrës dhe i verës është i lejuar nga		
Shitja, dhënia dhe konsumi i rakive, i alkopopsëve (pijeve të ëmbla alkoolike), i spirituozeve (alkoolleve të pastra) lejohet nga		

(informacione më të hollësishme mund të gjeni në:
www.sfa-ispa.ch)

Rekomandime të përgjithshme

- Përpiquni të mbeteni në kontakt me fëmijën e Juaj edhe në situata të vështira.
- Vrojtjeni sjelljen e tij me medime, si me TV, internet, hendi.
- Ndërhyni në rast të ndryshimit të sjelljeve.
- Mos ju ikni bisedave të hapura. Vetëm kështu mund të ndërtohet besimi dhe mirëkuptimi reciprok.
- Merrni në konsideratë, në rast nevojë, ndihmën e ofruar (shiko fletën e bashkangjitur mbi zyrat profesionale).

Dhe para së gjithash:

Tregoni interesim për përditshmërinë e fëmijës Suaj !

Botuese:

Grupi i punës Rinia e komunave glow.

Glow është një hapësirë e mëvetëshme jetësore dhe ekonomike me mëse 100'000 banorë dhe banorë. Kjo hapësirë përfshin tetë komuna: **Bassersdorf, Dietlikon, Dübendorf, Kloten, Opfikon, Rümlang, Wallisellen dhe Wangen-Brüttisellen.**

Në grupin e punës mbi rininë janë përfshirë të tetë komunat me nga një politikan/e dhe me një person profesionist mbi rininë. Grupi i punës merret me tema të ndryshme ndërkomunale mbi rininë dhe me lansimin e projekteve.

Kjo broshurë mund të merret në këto gjuhë: shqip, gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht, portugezisht, serbokroatisht, spanjollisht, tamilisht dhe turqisht.

(broshurën dhe adresën të tjera të dobishme gjeni në:
www.glow.ch)



Doracak për prindërit e të rinjve



Të dashur prindër

Të rinjtë në fazën e shkëputjes nga shtëpia prindore janë në kërkim të identitetit të tyre. Ju si prindër përkrahni fëmijët e Juaj në këtë kërkim duke ju ofruar atyre hapësira të lira, por edhe edhe mbështetje dhe ngrohtësi. Diskutoni aktivisht me fëmijët e Juaj, bëni marrëveshje dhe tregohuni të gatshëm që ato t'i rishikoni herë pas here. Falni besim fëmijëve të Juaj, por edhe tregoni atyre kufij të qartë.

Ky doracak udhëzues synon t'ju ndihmojë në përditshmerinë e Juaj prej edukuesve dhe të shërbejë si bazë për bisedë me fëmijën e Juaj.

Paratë e xhepit

Fëmijët dhe të rinjtë mësojnë të shkojnë me paratë, vetëm nëse posedojnë rregullisht të ardhura të vogla. Për këtë arsye është me rëndësi që të rinjve t'ju jepen rregullisht paratë e xhepit, të cilat ata do të mund t'i administrojnë vetë.

Ju rekomandojmë, sipas „Budgetberatung Schweiz“ (“Këshillimi buxhetor Zvicër”) këtë pagesë mujore nga cikli i mesëm i shkollimit fillor:

Viti i 5-të dhe i 6-të i shkollimit	25 deri 30. Fr. në muaj
Viti i 7-të dhe i 8-të i shkollimit	30. deri 40.- Fr. në muaj
Viti i 9-të dhe i 10-të shkollor	40. deri 50.- Fr. në muaj
Nga viti i 11-të shkollor	50. deri 80.- Fr. në muaj

(informacione më të hollësishme gjeni në internet në: www.asb-budget.ch)

Dalja

Këto pyetje ia vlen t'i diskutoni me fëmijën e Juaj:

- Ku po shkon?
- Si shkon atje dhe si kthehesh?
- Me kë takohesh?
- Kur kthehesh në shtëpi?
- Si mund të arrihesh?
- A e ke me vete hendin (telefonin e dorës), a e ke të mabushur aku-në?

Kërkoni me çdo kusht përgjegjshmëri dhe obligojeni fëmijën e Juaj që të lajmërohet menjëherë, nëse nuk mund t'ju përmbahet afateve të përcaktuara kohore. Garantoni edhe Ju arritshmërinë e Juaj.

Këto rekomandime mund t'ju shërbejnë si principe :

	Gjatë javës/jashtë kohës së pushimeve	Fundjava dhe/ose pushimet
12-14-vjeq	ora 20.00	ora 22.00
deri 16 vjeq	ora 22.00	ora 24.00

Festat dhe eventet

Edhe këtu ia vlen të parashtrihen pyetjet:

- Kush e organizon festën?
- Ku mbahet festa?
- Sa zgjat festa?
- Cilët persona të rritur janë përgjegjës?
- Si dhe kur kthehesh në shtëpi?

Nëse fëmija Juaj nuk është në gjendje t'ju përgjigjet këtyre pyetjeve, nuk këshilloheni ti jepni lejen e daljes.

Hendi (telefoni i dorës)

Hendi mund të jetë i dobishëm në raste rreziqesh dhe të ofron siguri. Veç kësaj ai ofron edhe mundësi kontakti mes të rinjve dhe mes Juve si prind dhe fëmijës. Këtu preferohen të merren parasysh këto pika:

- Prepaid-kartë në vend të kontratës – kështu mund të kontrollohen më mirë shpenzimet.
- Prepaid-karta mund të mbushet çdoherë në të njëjtën kohë (p.sh. në fillim të muajit).
- Nëse Ju merrni pjesë në shpenzime, do të ishte mirë të merreni vesh për ndonjë kontribut kompenzues të fëmijës Suaj.

(informacione më të hollësishme gjeni në internet në: www.zischtig.ch)

TV-ja, plejstejshën (playstation), kompjuteri

- Mos i lejeni fëmijës Suaj lojëra, faqe interneti apo filma pornografikë dhe ku lavdërohet dhuna.
- Veni re udhëzimet mbi moshën e përdorimit të DVD-ve dhe të lojërave kompjuterike.
- Merruni vesh mbi kohën maksimale të obligueshme ditore/ javore të shfrytëzimit.
- Krijoni mundësi të përhershëm kontrolli të konsumit të medimeve të fëmijës Suaj.
- Bëni marrëveshje të qarta mbi përmbajtjen e web-faqeve të vizituara.
- Instaloni një internetfilter.
- Në përgjithësi nuk duhet të bëhen të ditura të dhëna personale apo të vendosen të dhëna personale/fotografi në internet. Bëjeni me dije fëmijën e Juaj mbi këto rreziqe.

(informacione më të hollësishme gjeni në internet në: www.zischtig.ch)